REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr.4732Prot Maliq, më 18.08.2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. 3 datë 18 .08.2025

"Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2025"

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma (dh) , Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë" neni 32,"Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore" , ligjit nr.68,datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.4, datë 31.01.2025 "Miratimi i buxhetit shtesë për vitin 2025 të Bashkisë Maliq " , Udhëzimit të Ministrisë të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025" i propozoj Këshillit të Bashkisë :

1. Të miratojë një ndryshim në buxhetin e bashkisë për vitin 2025 si më poshtë,

Pakësim *000/lekë*

Gr.	Kap.	Kod. Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti		
00	05	04520	602	9999999	"Riparim ura"	**1.200**

Shtesë

Gr.	Kap.	Kod. Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti		
00	05	0 1110	230		Hartim Projektesh	**1.200**

2. Fondi i lartpërmendur i miratuar nga Këshilli i Bashkisë në nivel programi detajohet nga Kryetari I Bashkisë për objekte të veçanta.
3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashki.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Korçë.

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

Nr. 4532 prot

RELACION

"Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2025"

Fondi "Riprim Ura" i parashikuar në buxhetin shtesë të Bashkisë Maliq për vitin 2025 në shumën **1,200,000 lekë**, me Projekt-Vendimin e mësipërm ju propozohet për të kaluar në hartim projekte.

Në këtë kuadër synojmë të realizojmë disa projekte në varësi të fondit limit të përllogaritur dhe procedurave të prokurimit që do të realizohen..

1. **Hartim Projekti "Skemë ujitëse me pika Rezervuari Leminot "**
   Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes në zonën Leminot -Pirg të Nj A Pirg. Kërkojmë të ngremë një skemë moderne për ujitjen me pika e cila do të përmirësojë ndjeshëm situatën duke siguruar shpërndarjen më efikase të ujit,reduktim të humbjeve dhe përdorim për të gjithë sezonin veror të ujitjes.
   Me anë të këtij projekti synohet që në bazë të kapacitetit që ka rezervuari të mundësojmë ujitjen e një sipërfaqe toke bujqësore prej 250 ha me 4-5 ujitje në sezon.

2. **Hartim Projekti " Ndërtim Rrjeti KUZ Zvezdë "**
3. **Hartim Projekti "Sistemim lulishte para bashkisë"**

Konceptoi:

Almira Muka

Genci Floqi

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU